



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8145 Prot

Shkodër, më 20.05.2022

**URDHËR**  
Nr. 419, datë 20.05.2022

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ORGANIZMIN DHE REALIZIMIN E FESTIVALIT TË 60-TË MBARËKOMBËTAR TË KËNGËS PËR FËMIJË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar; VKB nr.3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm për përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”.

**URDHËROJ:**

1. Riorganizimin e grupit të punës për realizimin e Festivalit të 60-të Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë;
2. Grupi i punës do të përbëhet nga:
  - a) Z.Roland Guli, Drejtues Artistik
  - b) Z.Ermir Zoga, instruktor pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”
  - c) Ergys Ivziku Drejtor, Drejtoria Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Shkodër;
  - d) Znj.Manjola Lloja Bushati, koordinatore;
  - e) Terezina Hila, Drejtor, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
  - f) Brunilda Lleshi, Përgjegjëse, Sektori i Artit dhe Trashëgimisë Kulturore;

3. Grupi i punës do të organizojë planin organizativ të realizimit të Festivalit të 60-të Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë, në përputhje me përcaktimet e projektit të miratuar në fishbuxhetin P09120.O2.A2 “Festivali i 60-të bashkëlidhur këtij urdhëri;
4. Grupi i punës duhet të vlerësojë bashkëpunime të mundshme me të tretë, në kuadër të pasurimit të aktiviteteve të vitit jubilar të Festivalit të 60-të Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë;
5. Për zbatimin e urdhërit ngarkohet Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija”
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BARDH SPAHIA**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV.KRYETARI**

**ARDIT ÇYLYBYLI**

